

HISTORIA JONË

Komuniteti lind më 7 tetor 1951 në kuneo (Itali) atëherë kur at Andrea Gasparino, prifti I ri I dioqezës së kuneos, mirëpret 5 djem të mbetur pa shtëpi e pa familje pas fundit të luftës së dytë botërore (1940-1945).

Pak nga pak djemtë shtohen duke I dhënë jetë atij që më vonë do të quhej “qyteti I të rinjve”. Për tu kujdesur për këta djem fillimisht bashkohen me atin një grup vullnetarësh dhe më pas motrat e shuguruara. Qysh në fillimin gjithcka jetohet me një besim të plotë në provaninë e Zotit, dhe shumë shpejt del në pah rëndësia e lutjes, mbi të gjitha përballë shumë situatave të vuajtjeve të djemve.

Një vendim që e shpreh domëthënien e kësaj rëndësie është fillimi I adhurimit eukaristik të vazhdueshëm qysh nga 11 Shkurti 1959.

Qysh nga momenti behet gjithnjë e më fortë dëshira e komunitetit për tu shërbyer të varfërve në vendet më të varfra. Ëndërra për tu nisur në mision konkretizohet në 1961 në Brazil dhe më pas në shumë vende të tjera, deri në Azi, Afrikë dhe në Europën lindore. Në cdo mision dy shtylla kryesore janë lutja, gjithmonë e orientuar drejt eukaristisë, dhe bashkëndarja e jetës me të varfërit bashkë me vuajtjet e tyre, duke patur gjithmonë një raport miqësor me personat.

Në gjysmën e dytë të viteve “60” sapo komuniteti njihet me figurën dhe shkrimet e At de Fuko, zbulon një sintoni të thellë dhe për këtë arsye sot mban emrin e tij.

Në të njëjtën kohë me nisjen e misioneve komuniteti ndihet I thirrur që të bashkëndajë dhuratën e lutjes dhe të fjalës së zotit me të rinjtë, me familjet, me të gjithë bashkëpunëtorët.

Në 1990 komuniteti njihet dhe provohet nga selia e shenjtë si lëvizja kontemplative misionare “AT de FUKO” duke përfshirë kështu të gjithë ata, që në kushte të ndryshme jete, e gjejnë veten në përshpirtërinë e tij.